

30 mars 2026,  
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) të datës 30.08.2023, si dhe në trajtim të kërkesave për inicim të procedurës disiplinore të datës 19.03.2026 dhe 20.03.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), me datë 30.03.2026 merr këtë:

## V E N D I M

- I. SHQIPTOHET masa disiplinore “Ndalesë kryerje të detyrës për periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj” ndaj z. Endrit Basha, përfaqësues i KBF Peja 03, për shkelje disiplinore sipas Nenit 47(1)(g) dhe Nenit 46(2)(b);
- II. Masa disiplinore e përcaktuar në pikën I të këtij vendimi nënkupton ndalimin e ushtrimit të çdo funksioni zyrtar nga z. Endrit Basha, në të gjitha ndeshjet dhe aktivitetet e organizuara nga FBK, përfshirë por pa u kufizuar në, përfaqësimin e klubit, komunikimin me zyrtarë të garës dhe ushtrimin e çdo kompetence që buron nga funksioni zyrtar;
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

## A R S Y E T I M

Më datë 19.03.2026 dhe 19.03.2026, Komisioni Disiplinor i FBK-së (“KD”), përmes postës elektronike, ka pranuar kërkesën për inicim të procedurës disiplinore (tash e tutje “Kërkesat”), të cilat kanë të bëjnë me supozimin për shkelje disiplinore lidhur me menaxhimin dhe administrimin e garave të FBK-së, dhe lidhur me garat, dhunën dhe dukuritë tjera negative në sport, ndaj Drejtorit të Përgjithshëm të KBF Peja 03, z. Endrit Basha, në ndeshjen finale të Ligës Unike Femrat të zhvilluar me datë 18 mars 2026, në Palestrën Sportive “Sezai Surroi” në Prizren, ndërmjet KBF Bashkimi dhe KBF Peja 03.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, KD, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 24.03.2026, në orën 16:00, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç’ rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, KD, në përbërje të plotë dhe aprovim të të gjithë anëtarëve vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores

Disiplinore, nëpërmjet administratës së FBK-së, t'i kërkohet deklaratë me shkrim palës ndaj të cilit është iniciuar procedura.

Më datën 25.03.2026, KD, nëpërmjet email-it, sipas kërkesës, ka pranuar deklaratën me shkrim nga z. Endrit Basha.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 24.03.2026, KD ka mbajtur takim edhe me datë 27.03.2026, ku ka shqyrtuar deklaratën me shkrim nga z. Basha dhe provat e tjera të administruara nga sekretaria, përfshirë deklaratën nga delegatja e ndeshjes. Gjatë shqyrtimit, KD ka analizuar të gjitha dokumentet dhe provat në dispozicion, bazën ligjore, si dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv për arsyet e mëposhtme.

Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit të provave dhe rrethanave të rastit, ka konstatuar se z. Endrit Basha, në cilësinë e përfaqësuesit të KBF Peja 03, ka kryer shkelje disiplinore të parashikuara me:

- I. nenin 46 paragrafi 2 pika (b) të Rregullores Disiplinore, për shkak të komenteve publike përmes mjeteve të komunikimit, të drejtuara ndaj garave të FBK-së dhe një tjetër klubi; dhe
- II. nenin 48 paragrafi 1 pika (g) të Rregullores Disiplinore, për shkak të fyerjes ndaj zyrtarëve të ndeshjes dhe FBK-së.

Nga faktet e vërtetuara rezulton se sjellja e z. Basha ka qenë e drejtuar ndaj zyrtarëve të ndeshjes dhe vet FBK-së si institucion, si në formë publike përmes postimit, ashtu edhe përmes reagimeve të drejtpërdrejta gjatë ndeshjes, duke cenuar integritetin e garave dhe autoritetin e organeve zyrtare të basketbollit.

Në përputhje me nenin 26 të Rregullores Disiplinore, Komisioni fillimisht ka vlerësuar secilën shkelje veç e veç:

- I. Për shkeljen sipas nenit 46(2)(b), është vlerësuar masë e lehtë disiplinore (vërejtje);
- II. Për shkeljen sipas nenit 48(1)(g), bëhet fjalë për shkelje më të rëndë që cenon drejtpërdrejt integritetin e garave dhe autoritetin e organeve zyrtare të basketbollit.

Duke qenë se kemi të bëjmë me shkelje të shumëfishta, Komisioni ka aplikuar nenin 26 të Rregullores, sipas të cilit dënimet bashkohen në një dënim të vetëm, i cili duhet të jetë më i madh se secili dënim individual, por brenda kufijve të përgjithshëm të paraparë.


Komisioni, në përputhje me nenin 23 të Rregullores Disiplinore, ka marrë në konsideratë të gjitha rrethanat ndikuese në matjen e dënimit, duke vlerësuar peshën e shkeljes dhe pasojat e saj në cenimin e autoritetit të zyrtarëve dhe imazhit të garave të FBK-së, shkallën e përgjegjësisë së të dënuarit duke qenë se veprimet janë kryer me vetëdije dhe në mënyrë të përsëritur, si dhe rrethanat në të cilat janë kryer shkeljet, përkatësisht përmes rrjeteve sociale ashtu edhe në kontekst të drejtpërdrejtë sportiv.

Në kuadër të nenit 24, Komisioni ka konstatuar ekzistimin e rrethanave rënduese, duke marrë parasysh se i dënuari është recidivist me tri raste të mëparshme disiplinore të regjistruara në FBK që nga viti 2023, si dhe faktin se sjellja ka prodhuar ndikim negativ në mjedisin sportiv, ndërsa edhe pse nuk plotësohen kushtet formale për aplikimin e nenit 28 lidhur me dyfishimin e dënimit, mos-përmirësimi i sjelljes është vlerësuar si element rëndues.

Njëkohësisht, në përputhje me nenin 25, si rrethana lehtësuese janë marrë parasysh kontributi shumëvjeçar i z. Basha në zhvillimin e basketbollit, veçanërisht në kategorinë e femrave, si dhe pranimi i pjesshëm i sjelljes së papërshtatshme, megjithatë këto rrethana nuk janë konsideruar të mjaftueshme për të justifikuar një ulje më të ndjeshme të dënimit për shkak të peshës së shkeljeve dhe karakterit të tyre të përsëritur.

Rrjedhimisht, duke u bazuar në parimin e proporcionalitetit, si dhe duke marrë parasysh natyrën dhe seriozitetin e shkeljeve, faktin se kemi shkelje të shumëfishta, ekzistimin e rrethanave rënduese (recidivizëm), dhe rrethanat lehtësuese të kufizuara, Komisioni ka vlerësuar se masa disiplinore **“Ndalesë e kryerjes së detyrës për periudhë prej dymbëdhjetë (12) muaj”** është proporcionale, e arsyeshme dhe e nevojshme për arritjen e qëllimit disiplinor, gjegjësisht parandalimin e sjelljeve të ngjashme në të ardhmen, mbrojtjen e integritetit të garave, dhe ruajtjen e autoritetit të organeve dhe zyrtarëve të FBK-së. Bazuar në të gjitha sa më sipër, KD vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Disiplinor:



Afrim Kamishi  
Anëtar



Omer Daku  
Kryetar



Blerim Vuniqi  
Anëtar

Prishtinë, 30 mars 2026



Vendimi i dërgohet:

- z. Endrit Basha
- KBF Peja 03
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor
- Arkivit të FBK-së

***Këshilla Juridike:***

*Kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Ankesave dhe Arbitrazhit. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën prej 300€, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.*